c) monitorimin e vijës bregdetare, ku përfshihet dhe rada portuale, të shtretërve dhe brigjeve të lumenjve, përrenjve, liqeneve, pellgjeve, lagunave dhe ujëmbledhësve natyrorë apo artificialë, ishujve dhe grumbullimeve të rërës, gurëve dhe dherave në shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, tokës së përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit, kur ajo lidhet me tokën, zonave të mbrojtura mjedisore, si dhe venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane;

ç) mbështetjen në reagim të emergjencave civile në raste tërmetesh, uraganesh, përmbytjesh dhe zjarresh, duke ofruar vëzhgime ajrore për vlerësim paraprak të dëmeve;

d) monitorimin e vatrave/zonave të zjarrit, për të gjurmuar përparimin e zjarrit dhe për të identifikuar pikat e nxehta;

dh) zhvillimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) në gjetjen e të mbijetuarve, vlerësimin e dëmtimit të infrastrukturës dhe koordinimin e përpjekjeve të ndihmës, në gjetjen e personave/mjeteve të humbura/zhdukura ose individëve të bllokuar;

e) inspektimin vizual nga ajri të infrastrukturës kritike kombëtare dhe infrastrukturës kritike me efekt ndërkombëtar;

ë) fotografimin ajror të territorit me qëllim krijimin, administrimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit gjeohapësinor për institucionet publike;

f) plotësimin e kërkesave të institucioneve publike për fotografimin ajror, me qëllim krijimin e informacionit gjeohapësinor, i cili administrohet dhe koordinohet nga ASIG-u;

g) kryerjen e studimeve dhe kërkimeve shkencore që ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë e të mbrojtjes;

gj) mbështetjen e operacioneve të rëndësishme policore në zbatim të një plani kombëtar veprimi ose strategjie të miratuar sipas ligjit;

h) mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme, të parashikuara me ligj;

i) monitorimin dhe inspektimin e situatës ndërtimore në të gjithë territorin, duke përfshirë zonat me rëndësi kombëtare, monumentet e kulturës, qendrat historike, parqet dhe zonat arkeologjike, zonat e mbrojtura natyrore dhe monumentet natyrore;

j) monitorimin e ecurisë së projekteve strategjike në zhvillim;

k) monitorimin e terminaleve të shkarkimit dhe depozitimit të lëndëve hidrokarbure;

l) monitorimin e burimeve natyrore në sektorin minerar dhe hidrokarbur.

2. Çdo vit, Ministria e Mbrojtjes miraton orët e fluturimit për misionet e planifikuara apo të paplanifikuara, të ndara për çdo institucion shtetëror që ka kërkuar apo mund të kërkojë shërbim nga strukturat e mjeteve ajrore pa pilot.

3. Ministria e Mbrojtjes krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e operacioneve të mjeteve ajrore pa pilot, për drejtimin dhe bashkërendimin e punëve, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut III, të këtij vendimi, për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.

4. Koordinimi, drejtimi, komandimi, raportimi, shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera shtetërore dhe procedurat që ndiqen për angazhimin e strukturave të mjeteve ajrore pa pilot përcaktohen në dokumentin "Procedurat standarde të veprimit", të miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

V. BASHKËRENDIMI, PLANIFIKIMI DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

1. Institucionet shtetërore të përmendura në kreun III bashkëpunojnë me Ministrinë e Mbrojtjes për përfitimin e shërbimit të kërkuar nga mjetet ajrore pa pilot.

2. Çdo institucion cakton një përfaqësues për të koordinuar punën me strukturat përgjegjëse në Ministrinë Mbrojtjes, me qëllim planifikimin dhe realizimin me sukses të operacionit, që ka lidhje me institucionet që ata përfaqësojnë dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e këtyre planeve.

3. Çdo fillimviti kalendarik, institucionet shtetërore paraqesin kërkesë për orët e fluturimit që kërkojnë në dispozicion për mjetet ajrore pa pilot.

4. Ministria e Mbrojtjes dhe ministria përgjegjëse për infrastrukturën bëjnë të mundur sigurimin e fluturimit ajror për mjetet ajrore pa pilot.

5. Institucionet shtetërore bashkëveprojnë ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes për trajnimin dhe angazhimin, me qëllim përdorimin e burimeve në mënyrë racionale dhe rritjen e efektshmërisë operacionale të mjeteve ajrore pa pilot.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për hartimin e dokumentit "Procedurat standarde të veprimit", për përdorimin operacional të mjeteve ajrore pa pilot, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet shtetërore të përmendura në kreun II për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 551, datë 4.9.2024

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E PËRFAQËSIMIT TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE NË KËSHILLIN KONSULTATIV TREPALËSH RAJONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 200/1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal (në vijim "KKTR") është organ rajonal konsultativ trepalësh, në nivel qarku, me përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të organizatave të punëmarrësve dhe përfaqësues të strukturave shtetërore në nivel qarku.

2. Këshillat konsultativë trepalësh rajonalë zhvillojnë konsultime për çështje me rëndësi rajonale në interes të përbashkët të palëve, marrin vendime dhe i bëjnë rekomandimet përkatëse këshillit të qarkut ose këshillit bashkiak, sipas kompetencës territoriale. Këshilli merr vendime duke u shprehur me votë pro, kundër ose abstenim dhe për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit, kuorumi i nevojshëm të jetë më shumë se gjysma e përfaqësuesve të secilës palë.

3. Çdo organizatë përfaqësuese e punëmarrësve dhe e punëdhënësve, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe administrata shtetërore në nivel qarku duhet të vërë në dispozicion të Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal, çështje që kanë të bëjnë me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, higjienën dhe sigurimin teknik, prodhimin, mirëqenien, arsimin, si dhe çështje ekonomike, që do të konsultohen në këtë këshill.

4. Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë dhe 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë zëvendësues, me këtë përbërje:

a) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues nga organizatat sindikale;

b) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues nga organizatat e punëdhënësve;

c) 5 (pesë) anëtarë dhe 5 (pesë) anëtarë zëvendësues, me përfaqësim nga organet e qeverisjes vendore.

5. Çdo këshill konsultativ trepalësh rajonal kryesohet nga prefekti dhe ka në përbërje prefektin dhe katër kryetarët e bashkive me numrin më të madh të banorëve.

6. Përzgjedhja e anëtarëve, përfaqësues të organizatave sindikale dhe organizatave të punëdhënësve, përcaktohet sipas treguesve të parashikuar në pikën 4, të nenit 200/1, të Kodit të Punës. Emërimi i anëtarëve të organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale bëhet nga prefekti, sipas propozimeve të vetë organizatave.

7. Kryetari i KKTR-së ka këto detyra:

a) drejton mbledhjet e këshillit;

b) miraton rendin e ditës, raportin përfundimtar të mbledhjeve, si dhe programin vjetor të këshillit, në bazë të mirëkuptimit ndërmjet palëve;

c) informon këshillin e qarkut ose këshillin bashkiak për rekomandimet e tij, si dhe për mendimet e organizatave punëmarrëse dhe punëdhënëse në shkallë qarku;

ç) cakton nënkryetarët e palëve, në konsultim me përfaqësuesit e organizatave sindikale dhe punëdhënësve, anëtarë të këshillit.

8. KKTR-ja, në çdo qark, mblidhet në përputhje me programin e miratuar ose me kërkesën me shkrim të çdo pale, sipas përcaktimit të bërë në rregulloren e brendshme të funksionimit, por jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Çdo këshill harton rregulloren e vet të brendshme, mbështetur në specifikat e çdo qarku.

9. Anëtarët e këshillit, për çështjet që do të diskutohen, kanë të drejtën e këshillimit paraprak dhe shprehin qëndrimin e tyre nëpërmjet nënkryetarit të palës.

10. Për funksionimin e këshillit caktohet një sekretariat i përbërë nga 3 (tre) nëpunës të administratës së prefektit të qarkut.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 552, datë 4.9.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 580, DATË 11.10.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TEK MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR FONDACIONIN "*DURRAH CITY FOOTBALL ACADEMY*", TË PRONAVE SHTETËRORE ME NUMËR PASURIE 79/1 DHE 80/1, PJESË E ZONËS KADASTRALE NR. 8517, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, PËR NDËRTIMIN DHE ZHVILLIMIN E KOMPLEKSIT TË AKADEMISË SË FUTBOLLIT DURRËS, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 262, DATË 6.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SPITALLË, DURRËS", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 580, datë 11.10.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Ministria e Arsimit dhe Sportit, për fondacionin *"Durrah City Football Academy",* të pronave shtetërore me numër pasurie 79/1 dhe 80/1, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, për ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për kalimin në përgjegjësi administrimi te Ministria e Arsimit dhe Sportit, për fondacionin "*Durrah City Football Academy*", të pronave shtetërore me numër pasurie 79/1, 80/1 dhe 301/2, pjesë të zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, për ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës dhe Qendrës Sportive "Rafael Nadal", si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 262, datë 6.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës", të ndryshuar.".

2. Në pikën 1 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas togfjalëshit "... me sipërfaqe 104 580 m^2 ..." shtohen fjalët "... si dhe nr. 301/2, me sipërfaqe 3 120 (tre mijë e njëqind e njëzet) m^2 ...";

b) Pas emërtimit "Akademisë së Futbollit Durrës" shtohen fjalët " ... dhe Qendrës Sportive "Rafael Nadal" ...".

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të përdoren për ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës dhe të Qendrës Sportive "Rafael Nadal", të ambienteve sportive dhe çdo shërbimi të nevojshëm, në funksion të promovimit dhe zhvillimit të sportit të futbollit, tenisit dhe sporteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, si dhe për realizimin e funksioneve të fondacionit, i cili i menaxhon këto komplekse.".

4. Pas aneksit 1 bashkëlidhur vendimit shtohet aneksi 1/1, ku përcaktohen kartela e pasurisë dhe fragmenti i hartës kadastrale për pronën shtetërore me numër pasurie 301/2, me sipërfaqe 3 120 (tre mijë e njëqind e njëzet) m^2, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, fondacioni "*Durrah City Football Academy*" dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8517004217
(Nga ____ , Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8517 , Lloji i Pasurisë: ARE , Nr. i Pasurisë: 301/2 , Sipërfaqja Totale 3120 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)
Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-87(239-D)87(255-B), Numri i Pemëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia DURRES , Rruga SPITALLE , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:
Fillestare __ (Akti Nr. __ , Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTETI , Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: P
Adresa e Pronarit: Bashkia Shtet , Rruga - , Ndërtesa Nr. __ , SH/K __ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. LN.11.1996 , Datë: 04/12/1996

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: KORRIGJOHET ZERI KADASTRAL ME URDHER NR. 1763 DATE 22.08.2024 (REF: 10170).

DREJTORI
Elvis Pengili

Besmir Ahmeti — Digitally signed by: Besmir Ahmeti Date: 2024.08.22 05:23:45 +02'00'
Lindita Gjoni — Digitally signed by: Lindita Gjoni Date: 2024.08.22 05:45:06 +02'00'
Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili Date: 2024.08.22 05:47:02 +02'00'

Data e lëshimit 22/08/2024

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Durrës
Date:2024/08/22 17:23:23 +02'00'
M32202701W2024082217231641ASH

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE			
ZONA KADASTRALE:	8517	KODI UNIK:	8517004217
NUMRI PASURISË:	301/2	INDEKSI HARTËS:	K-34-87-(239-D255-B)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

SH 1: 2500

DREJTORI

Lindita Gjoni — Digitally signed by: Lindita Gjoni, Date: 2024.08.22

Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili, Date: 2024.08.22

Data e leshimit 20.08.2024

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Durrës
Date:2024/08/22 17:44:12 +02'00'
M32202701W2024082217440572014

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Durrës)

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 6, datë 22.7.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR FORMËN E KËRKESËS, PROCEDURËN DHE PËRKTHIMIN E AKTEVE NË MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, dhe nenit 148/b, shkronja "dh", të Kushtetutës; nenit 38, pika 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 15, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar; si dhe nenit 5, pika 3, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar, ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme

UDHËZOJNË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e rregullave të detajuara për formën dhe përmbajtjen e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve, në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

Neni 2
Kërkesat

Kuptimi i termit "kërkesë" në zbatim të këtij udhëzimi, ka të njëjtin kuptim me llojet e kërkesave të përcaktuara në nenin 4, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar.

KREU II
RREGULLA MBI FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE PARAQITJEN E KËRKESËS

Neni 3
Forma e kërkesës

1. Forma e kërkesës përcaktohet në përputhje me aktet ndërkombëtare që caktojnë rregulla për marrëdhëniet juridiksionale në fushën penale, që janë bërë pjesë e legjislacionit shqiptar, si dhe legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

2. Formati i kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale është sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 4
Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesat e autoriteteve gjyqësore vendëse paraqiten me shkrim dhe, përveçse kur legjislacioni në fuqi parashikon ndryshe, duhet të përmbajnë:

a) organin që ka lëshuar kërkesën dhe adresën e tyre, si dhe emrin e personit të kontaktit me adresën e *e-mail,* numrin e telefonit dhe të faksin. Organi që lëshon kërkesën shënon edhe emrin e organit të huaj nëse është në dijeni të tij. Kur nuk është e mundur të identifikohet organi konkret, të cilit i drejtohet kërkesa, shënohet vetëm emri i autoritetit qendror të shtetit të kërkuar;

b) emërtesën e saktë të llojit të kërkesës "letërporosi", "kërkesë për ekstradim", "kërkesë për njohje dhe ekzekutim të vendimeve gjyqësore të huaja", "kërkesë për transferim të procedimeve penale", "kërkesë për transferim të personave të dënuar", "kërkesë për ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore" ose çdo lloj kërkese tjetër të parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare dy- apo shumëpalëshe, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Në kërkesë përcaktohet edhe arsyeja për të cilën organi ka vlerësuar për paraqitjen e kësaj kërkese, duke cituar edhe nenet përkatëse të aktit ndërkombëtar që i referohet, të Kodit të Procedurës Penale, të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar, si dhe të çdo akti tjetër që krijon

marrëdhënie juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale;

c) gjeneralitetet e personit apo të personave të përfshirë në objektin e kërkesës, duke përfshirë emrin, atësinë, mbiemrin, ditëlindjen/moshën, shtetësinë, vendqëndrimin, adresën, nëse kjo është e ditur, si dhe pozitën procedurale që personi apo personat kanë në procedimin penal;

ç) të dhëna mbi procedimin penal për të cilin dërgohet kërkesa lidhur me mënyrën e regjistrimit të tij, ecurinë, si dhe fazën procedurale të procedimit;

d) përshkrimin e faktit penal, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, vendin dhe kohën e ardhjes së pasojës, cilësimin juridik të veprës penale, të shoqëruar me kopje të tekstit të dispozitave ligjore që bëjnë parashikimin e veprës penale, llojin dhe masën e dënimit, si dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme për rastin për të cilin është paraqitur kërkesa;

dh) shënimin "Urgjent" në krye të kërkesës, nëse kërkesa është urgjente, duke saktësuar në përmbajtje të kërkesës edhe shkakun e urgjencës;

e) shënimin sipas niveleve të klasifikimit: "Tepër sekret", "Sekret", "I kufizuar" ose "Konfidencial", nëse kërkesa ka të dhëna që përbëjnë sekret shtetëror, sekret hetimor apo të dhëna sensitive dhe kërkimin e ruajtjes së konfidencialitetit në përmbajtjen e kërkesës;

ë) afatin brenda të cilit nevojitet ekzekutimi i kërkesës dhe shkakun e respektimit të këtij afati;

f) aktet e procedimit penal që kanë lidhje dhe ndihmojnë ekzekutimin e kërkesës, duke i evidentuar në një listë. Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës duhet të jenë në kopje të njësuara me origjinalin;

g) çdo informacion tjetër, që autoriteti gjyqësor e vlerëson me rëndësi për procedurën e ekzekutimit të kërkesës nga autoritetet e shtetit të huaj.

2. Kërkesa për krijimin e skuadrës së përbashkët hetimore, përveç informacioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë edhe propozimin për përbërjen e skuadrës hetimore, si dhe kohëzgjatjen e saj.

Neni 5
Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa e autoriteteve gjyqësore vendëse paraqitet e nënshkruar, e vulosur, e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm, si dhe me përkthimin në gjuhën e vendit të cilit i drejtohet kërkesa, ose në një gjuhë të pranuar prej tij, përkthim i cili realizohet nga Ministria e Drejtësisë. Praktika e plotë dërgohet pranë autoritetit të huaj nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë udhëzim.

2. Në raste të ngutshme përkthimi kryhet nga organi kërkues nëpërmjet përkthyesve zyrtarë të certifikuar dhe pjesë e listës së përkthyesve zyrtarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet kërkuese drejt autoriteteve të palës së cilës i drejtohet kërkesa, duke vënë në dispozicion të Ministrisë e Drejtësisë një kopje të praktikës.

3. Kërkesa paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë e nënshkruar nga prokurori që ka përpiluar kërkesën.

4. Kërkesa, dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë nga drejtuesi i prokurorisë së rrethit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm në rastin e kërkesave të lëshuara nga prokurori i juridiksionit të përgjithshëm. Përjashtimisht, për letërporositë për jashtë dhe transferimin e procedimit penal te shtetet e huaja, drejtuesi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, i përcjell kërkesën Ministrisë së Drejtësisë dhe një kopje të saj për dijeni Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Në rastin kur kërkesa bëhet nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, ajo dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

6. Kërkesa, përveç numrit të protokollit duhet të përmbajë edhe inicialet e prokurorit që ka nxjerrë kërkesën.

7. Kërkesa për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet Prokurorisë së Përgjithshme ose drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

8. Kërkesa i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë në 2 (dy) kopje, nga të cilat njëra qëndron në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa kopja tjetër i përcillet shtetit të kërkuar.

9. Si rregull, kërkesa dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar, korrierit diplomatik. Në raste të ngutshme mund të dorëzohet edhe nëpërmjet mjeteve të tjera teknike të përshtatshme, por me kusht që të konfirmohet marrja në dorëzim.

KREU III
PROCEDURA PËR PËRKTHIMIN E AKTEVE NË MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Neni 6
Përkthimi i kërkesave të autoriteteve gjyqësore vendëse

1. Kërkesat e autoriteteve gjyqësore vendëse dhe dokumentet shoqëruese, përkthehen nga Ministria e Drejtësisë. Në raste të ngutshme përkthimi kryhet nga organi që ka nxjerrë kërkesën nëpërmjet përkthyesve zyrtarë, që kanë nënshkruar kontratë me ministrinë e Drejtësisë. Përkthimi në këto raste, kryhet sipas legjislacionit në fuqi për përkthimin zyrtar.

2. Përkthimi i akteve bëhet në gjuhën e vendit të cilit i drejtohet kërkesa, ose në një gjuhë të pranuar prej tij.

3. Në rastin e përkthimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese nga Ministria e Drejtësisë, përkthimi i akteve do të kryhet nga përkthyesit zyrtarë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

4. Në rastet kur përkthimi realizohet nga organi që ka nxjerrë kërkesën, prokurori i dorëzon përkthyesit zyrtar kopjen e akteve drejtuar autoriteteve të huaja në ambientet e prokurorisë dhe përkthyesi i kthen aktet e përkthyera në të njëjtën mënyrë. Prokurori mban procesverbal ku evidenton numrin e faqeve kompjuterike të përkthyera dhe numrin e karaktereve.

5. Përkthimi i kërkesave të autoriteteve gjyqësore vendëse bëhet në respektim të afateve të parashikuar në legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në çështjet penale.

6. Në rastet kur Ministria e Drejtësisë, kryen përkthimin e letërporosive dhe të akteve shoqëruese të tyre, në kuadër të procedimeve penale (të prokurorive, si me juridiksion të përgjithshëm apo me juridiksion të posaçëm), drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja, gjithashtu, edhe akteve të autoriteteve të huaja në ekzekutim të këtyre letërporosive, Ministria e Drejtësisë duhet të dërgojë, në prokurorinë përkatës, bashkë me përkthimin ose kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi të administrohet, edhe një kopje të faturave dhe procesverbaleve përkatëse për përkthimin e akteve të lartpërmendura, me qëllim që këto fatura të bëhen pjesë e shpenzimeve të procedimit penal.

Neni 7
Përkthimi i kërkesave dhe i akteve të autoriteteve gjyqësore të huaja

1. Kërkesa e autoriteteve gjyqësore të huaja dhe dokumentet bashkëlidhur kërkesës, në rast se nuk shoqërohen me një kopje në gjuhën shqipe, përkthehen nga Ministria e Drejtësisë dhe më pas i përcillen prokurorisë kompetente me juridiksion të përgjithshëm nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ose kur është rasti drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2. Menjëherë pas marrjes së kërkesës nga autoritetet e huaja, nëse nuk konstatohen të meta, Ministria e Drejtësisë procedon me përkthimin e akteve.

3. Përkthimi i kërkesave të autoriteteve gjyqësore të huaja nga Ministria e Drejtësisë bëhet në respektim të afateve të parashikuar në legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në çështjet penale.

4. Aktet e përcjella nga autoritetet e huaja në përgjigje të kërkesës së autoriteteve vendëse përcillen nga Ministria e Drejtësisë pranë prokurorisë kompetente me juridiksion të përgjithshëm nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ose, kur është rasti, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

5. Në rastet e komunikimit të drejtpërdrejtë, organi i prokurorisë, pas administrimit të akteve të autoriteteve gjyqësore të huaja, i vendos këto akte në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë për përkthimin e tyre.

6. Kur përkthimi i akteve realizohet nga organi i prokurorisë, prokurori i dorëzon përkthyesit kopjen e akteve të autoriteteve të huaja në ambientet e prokurorisë dhe përkthyesi i kthen aktet e përkthyera në të njëjtën mënyrë. Prokurori mban procesverbal, ku evidenton numrin e faqeve kompjuterike të përkthyera dhe numrin e karaktereve. Përkthimi në këto raste kryhet sipas legjislacionit në fuqi për përkthimin zyrtar.

7. Në rastin e parashikuar në pikën 6 të këtij neni, një kopje e procesverbalit i përcillet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim pagesën e përkthyesit zyrtar.

Neni 8
Përkthimi i kërkesave në rastet e arrestit të përkohshëm

1. Në rastet e ngutshme të arrestimit të përkohshëm të personit, me kërkesë të Prokurorisë së Përgjithshme, ose të Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Ministria e Drejtësisë kryen përkthimin e akteve të kërkuara brenda 24 orëve.

2. Ministria e Drejtësisë, pasi kryen përkthimin e kërkesës dhe akteve shoqëruese, vendos në dispozicion të prokurorisë përkthimin e saj në rrugë postare dhe rrugë elektronike.

3. Komunikimet ndërmjet institucioneve të përfshira mund të kryhen edhe në rrugë elektronike.

Neni 9
Komunikimi elektronik i përkthimit

Kur është e mundur nga ana teknike, komunikimi i dokumentacionit për përkthim, mund të realizohet edhe në rrugë elektronike nëse dokumentet e përkthyera nënshkruhen elektronikisht nga përkthyesi.

Neni 10
Garantimi i ruajtjes së sekretit dhe i konfidencialitetit

1. Gjatë komunikimit dhe procesit të përkthimit garantohet ruajtja e sekretit dhe e konfidencialitetit.

2. Dokumentet e cilësuara si sekret shtetëror ose konfidenciale përkthehen nga përkthyes të pajisur me certifikatë sigurimi të personelit (CSP), sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11
Respektimi i rregullave të parashikuara

Shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë udhëzim mund të përbëjë shkelje disiplinore dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve përkatëse në kuadër të procedimit disiplinor për personat përgjegjës sipas ligjit.

Neni 12
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Rregullat e parashikuara në këtë udhëzim zbatohen nga prokurorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurorët në Prokurorinë e Posaçme, punonjësit e strukturave përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë dhe në organet e tjera të përfshira në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në veprimtarinë e tyre administrative, në kuadër të transmetimit të kërkesave, për aq sa nuk bien në kundërshtim me marrëveshjet shumëpalëshe ose dypalëshe në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, si dhe me legjislacionin në fuqi.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Neni 13
Njohja me përmbajtjen

Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ua bëjnë me dije këtë udhëzim të gjitha strukturave të cilat do të ngarkohen me zbatimin e tij.

Neni 14
Shfuqizime

Udhëzimi nr. 5, datë 21.7.2010, i ministrit të Drejtësisë dhe i prokurorit të Përgjithshëm "Për përcaktimin e rregullave mbi formën e letërkërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve", shfuqizohet.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim i përbashkët hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Olsian Çela

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
Altin Dumani

Shtojca nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

_____ Tiranë më ___.___.20__

Treguesi i urgjencës / Konfidencialitetit

KËRKESË PËR _____
DREJTUAR AUTORITETIT GJYQËSOR KOMPETENT TË_____ (*shëno Shtetin p.sh*: *Republika e Italisë, dhe nëse dihet saktësisht qytetin përkatës*)

***A.* TË DHËNAT E SUBJEKTIT:**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____ u kërkon autoriteteve _____ të drejtësisë dhënien e ndihmës juridike në kuadër të, procedimit penal nr. _____, datë _____ për veprën penale të _____, parashikuar nga _____ në ngarkim të _____,

(*Këtu të jepen gjithashtu të dhënat mbi subjektin (nëse ka) me të cilin lidhet objekti i letërporosisë si dhe të përcaktohet pozita e tij në procedim penal: i pandehur, dëshmitar, etj*)

Emri:
Mbiemri:
Aliase/Pseudonimi: [nëse ka]
Data e lindjes: [nëse nuk dihet mos e përfshini]
Vendi i lindjes: [nëse nuk dihet mos e përfshini]
Shtetësia: [nëse nuk dihet mos e përfshini]
Adresa: [adresa e vendbanimit ose vendqëndrimit]
Numri i identitetit: [nëse nuk dihet mos e përfshini]
Statusi në procedimin penal:
Masat kufizuese në ngarkim:

(Mund të plotësoni gjithashtu të dhëna të tjera që i konsideroni të arsyeshme, si psh numrin e pasaportës, përshkrimin fizik të subjektit, etj. Nëse është më shumë se një person, të dhënat e subjekteve të renditen në mënyrë kronologjike sipas përshkrimit tek përmbledhja e fakteve dhe sipas rëndësisë në lidhje me kërkesën. Kur personi është person juridik duhet të përfshihet: Emri, numri i regjistrimit, adresa e selisë qendrore apo degëve, të dhëna kontakti të personit juridik që mund të shërbejnë për kërkesën)

Kjo kërkesë është hartuar në gjuhën _____ dhe është përkthyer në gjuhën _____ (*Përcaktimi i gjuhës në të cilën është hartuar kërkesa dhe/ose gjuhën në të cilën është përkthyer*).

B. URGJENCA DHE PROCEDURA E POSAÇME:

(kur është rasti)

Urgjenca: _____

(*Në rast se veprimet e kërkuara paraqesin urgjencë t'u theksohet kjo gjë autoriteteve të huaja ose të përcaktohet një afat i arsyeshëm për realizimin e këtyre veprimeve, së bashku me arsyet e urgjencës apo afatit*).

Procedura e Posaçme _____*(në rast se nga ana juaj ka kërkesa specifike për mënyrën e ekzekutimit të letërporosisë, si përshembull marrja në pyetje e personit të bëhet para gjykatës së huaj, etj, të përcaktohet shprehimisht procedura që duhet ndjekur nga autoriteti i huaj. Kjo është e nevojshme pasi duhet pasur gjithmonë parasysh që provat e marra me letërporosi të pranohen nga gjykata. Autoritetit të huaj mund t'i kërkohet gjithashtu edhe përcjellja e një kopjeje të materialeve në ekzekutim të letërporosisë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përcaktuar se ku do të dërgohen, në Prokurorinë tuaj apo në Prokurorinë e Përgjithshme ose në Prokurorinë e Posaçme, ndërkohë që aktet origjinale t'i transmetohen ndërkohë autoritetit qendror, Ministrisë së Drejtësisë.*

Deklarojmë se, të dhënat/informacionet e marra në ekzekutim të kësaj letërporosie do të përdoren nga autoritetet gjyqësore shqiptare vetëm për nevoja të këtij procedimi penal në përputhje me legjislacionin kombëtar.

C. OBJEKTI DHE SHKAQET E DËRGIMIT TË KËRKESËS:

(Përcaktimi i objektit të kërkesës duke bërë një përmbledhje të shkurtër të fakteve që lidhen me procedimin penal përkatës duke renditur ato fakte për të cilat justifikohet dhe ndihma që u kërkohet autoriteteve të huaja, konkretisht:

(Përcaktimi i llojit të veprës penale dhe kualifikimi ligjor)

_____

_____

(Përmbledhje e fakteve relevante që tregojnë kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës)

_____

_____

_____

(Përshkrimi i qartë i lidhjeve ndërmjet veprës dhe personit dhe ndërmjet veprës dhe provave/ masave/ aseteve kriminale të kërkuara në shtetin e kërkuar)

_____

_____

_____

Dëme të shkaktuara nga vepra:

_____

_____

Informacion mbi viktimat:

_____

_____

Dispozitat mbi kalimin e afatit (kur është e nevojshme):

_____

(Listimi i akteve shoqëruese/mbështetëse të kërkesës):

_____

_____

_____

(Çdo informacion tjetër shtesë që mund të ndihmoj autoritetin kërkues në kryerjen e kërkesës)

_____

_____

D. TEKSTI I DISPOZITAVE LIGJORE TË ZBATUARA

(Të shënohet teksti i nenit apo neneve përkatëse të zbatueshme për rastin konkret)

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

_____

E. BAZA LIGJORE DHE NDIHMA E KËRKUAR

Mbështetur në *(të shënohet konventa shumëpalëshe apo marrëveshja dy-palëshe përkatëse në fuqi e cila mund të jetë një ose më shumë)* Konventën _____ për ____/Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe _____ kërkojmë nga ana e autoriteteve gjyqësore kompetente të _____, kryerjen e veprimeve të mëposhtme procedurale:

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

(Rendisni me saktësi veprimet e kërkuara në mënyrë sa më të detajuar si marrje në pyetje, marrje e provave, marrja e informacionit, marrja e të dhënave, kryerja e sekuestrimeve, kryerja e ekspertimeve, kryerjen e përgjimeve, kryerja e teknikave speciale të hetimit, transferimi i përkohshëm i personit të ndaluar, etj).

F. TË DHËNA MBI EKZEKUTIMIN E KËRKESËS:

(Përcaktimi i të dhënave që mund të lidhen me ekzekutimin e kërkesës si procedura e ekzekutimit të kërkesës, prezenca e përfaqësuesve të organit procedues, etj):
_____
_____

Modalitetet mbi përcjelljen e provave: _____
(Të përcaktohet shprehimisht kur provat duhet të merren në formë origjinale, si dhe rruga e përcjelljes pranë autoritetit kërkues, dërgimi i dokumenteve gjyqësore mbi njoftimin e urdhrave/vendimeve të autoriteteve gjyqësore/dokumenteve të tjera, njoftimin e aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim/ të pandehurit/dëshmitarit/ekspertit/të dënuarit apo palëve të tjera në proces, identifikimi i personit për të cilin kërkohet gjendja gjyqësore/rekordet kriminale, etj).

Kostot*:*_____
(Sipas parashikimit të Konventave apo marrëveshjet dy palëshe)

Gjuha në të cilën do të përcillen dokumentet*:*_____
(Sipas parashikimit të Konventave apo marrëveshjet dy palëshe)

Të dhëna lidhur me ruajtjen e konfidencialitetit*:* _____

Të dhëna lidhur me garantimin e të dhënave personale: _____

G. TË DHËNAT E KONTAKTIT

Për çdo informacion të mëtejshëm lidhur me këtë kërkesë, lutemi të kontaktoni me:

Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë
Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar
në: tel/fax:_____
e-mail:_____

Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë
Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë,
në: tel/fax: 00355 42 235232
e-mail: foreign.department@pp.gov.al

(ose sipas rastit)
Prokurorinë e Posaçme (SPAK) në Republikën e Shqipërisë
Seksioni i _____
në: tel/fax: _____
e-mail: _____

Prokurori: (Emër/Mbiemër)
Adresa:
Telefoni:
E-mail:

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin tuaj,

PROKURORI I ÇËSHTJES

(EMËR MBIEMËR)
nënshkrimi

URDHËR
Nr. 645, datë 28.8 2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 99, DATË 25.5.2021, "PËR MIRATIMIN E KATALOGUT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të nenit 17, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e ndryshimeve në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, sipas shtojcës 1, të bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Botimin e ndryshimeve të Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

SHTOJCA 1
NDRYSHIMET NË KATALOGUN KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE 2024

Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve 2024

Nr.	Varianti i mëparshëm i Kualifikimit Profesional	Kodi i Kualifikimit Profesional dhe i njësive të të rrëzëmit	Emërtimi i kualifikimeve	Emërtimi i njësive të të rrëzëmit	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me kodet e LKP/ISCO	Kualifikim i plotë/ pjesshëm	Niveli në KSHK
1	C-IV-19	**C-IV-24**	**Përpunim druri**		**Programe 1-vjeçar studimi për teknik/menaxher mesëm**	**Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit**	7522	**I plotë**	**4**
1-a		C-03-IV-0001-24		Planifikim, organizim dhe mbikëqyrje e procesit të prodhimit në përpunim druri	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-b		C-03-IV-0002-24		Sigurimi i cilësisë së punimeve	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-c		C-03-IV-0003-24		Mirëmbajtje e makinerive dhe instrumenteve punëtë të përpunim drurit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-d		C-03-IV-0004-24		Procesi i thartjes të lëndës drunore	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-e		C-32-IV-0005-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-f		C-31-IV-0006-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
1-g		C-03-IV-0007-24		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Përgjegjës prodhimi për përpunimin e drurit	7522	I pjesshëm	4
2	D3-III-19	**D3-III-24**	**Modelim**		**Program 1-vjeçar për punonjës të kualifikuar**	**Modelues**	7532	I plotë	**3**
2-a		D3-04-III-0087-24		Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-b		D3-04-III-0088-24		Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-c		D3-04-III-0089-24		Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-d		D3-04-III-0090-24		Njohuri mbi modën dhe estetikën	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-e		D3-04-III-0091-24		Realizimi i prototipit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-f		D3-04-III-0092-24		Konfeksionimi i produktit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-g		D3-04-III-0093-24		Kryerja e kontrollit të cilësisë	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-h		D3-32-III-0013-24		Sipërmarrja dhe edukim karriere	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-i		D3-31-III-0014-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
2-j		D3-04-III-0094-24		Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Modelues	7532	I pjesshëm	3
3	E3-III-19	**E3-III-23**	**Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake**		**Program 1-vjeçar për punonjës të kualifikuar**	**Riparues pajisjesh elektroshtëpiake**	7414	**I plotë**	**3**
3-a		E3-05-III-0031-24		Planifikimi dhe organizimi i punës riparim pajisjesh elektroshtëpiake	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-b		E3-05-III-0032-24		Ndërtimi dhe funksioni i pajisjeve elektroshtëpiake	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-c		E3-05-III-0033-24		Makina dhe transmisione elektrike	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-d		E3-05-III-0034-24		Elektronikë e zbatuar	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-e		E3-05-III-0035-24		Diagnostikimi i defekteve dhe parregullsive	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-f		E3-05-III-0036-24		Riparime dhe zëvendësime në pajisje elektroshtëpiake	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-g		E3-05-III-0037-24		Mirëmbajtja në pajisjet elektroshtëpiake	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-h		E3-32-III-0013-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-i		E3-31-III-0014-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
3-j		E3-05-III-0038-24		Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Riparues pajisjesh elektroshtëpiake	7414	I pjesshëm	3
4		**E1-V- 24**	**Energji e rinovueshme**		**Programe, pas të mesmes 1-vjeçare studimi**	**Tekniku elektrik i energjisë së rinovueshme**	3113	**I plotë**	**5**
4-a		E1-05-V-0172-24		Planifikimi, organizimi dhe dokumentimi i punës	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-b		E1-05-V-0173-24		Bazat e elektroteknikës	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-c		E1-05-V-0174-24		Montimi dhe instalimi i impianteve elektrike dhe mekanike në sistemet fotovoltaike	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-d		E1-05-V-0175-24		Instalimi i impianteve elektrike në sistemet e erës (eolike)	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-e		E1-05-V-0176-24		Konfigurimi i pajisjeve të kontrollit në sistemet fotovoltaike dhe të erës	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-f		E1-05-V-0177-24		Testimi dhe verifikimi i impiantit fotovoltaik dhe të erës për performancë dhe për mbrojtje	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-g		E1-05-V-0178-24		Monitorimi dhe shfrytëzimi i impianteve fotovoltaike dhe të erës	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-h		E1-05-V-0179-24		Mirëmbajtja dhe riparime në impiante fotovoltaike dhe të erës	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-i		E1-32-V-0106-24		Sipërmarrje dhe edukim karriere	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-j		E1-31-V-0125-24		Komunikimi dhe etika profesionale	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
4-k		E1-05-V-0180-24		Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknikë elektrik i energjisë së rinovueshme	3113	I pjesshëm	5
5	E5-III-13	**E5-IV-24**	**Teknologji automatizimi**		**Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm**	**Teknik automatizimi**	3139	**I plotë**	**4**
5-a		E5-05-IV-0181-24		Planifikimi dhe organizimi e punës në teknologjitë e automatizimit	Kualifikim i të rrëzëmit gjatë gjithë jetës	Teknik automatizimi	3139	I pjesshëm	4
MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "AGE ERZEN" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "HEKALI"

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a" dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", neneve 13 dhe 14, pika 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 814/16 prot., datë 29.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Age Erzen' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Hekali'",

konstatoi se:

- Shoqëria "Age Erzen" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/3 prot., datë 31.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Hekali", me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 127, datë 25.6.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Age Erzen" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Hekali", me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 26.6.2024 dhe 27.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.7.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 814/9 prot., datë 28.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/10 prot., datë 8.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, ka rezultuar se mbetej ende dokumentacion për t'u plotësuar, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 814/11 prot., datë 19.7.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/12 prot., datë 23.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Për sa më sipër, me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me të, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 149, datë 25.7.2023, u vendos zgjatja deri në 20 (njëzet) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë "Age Erzen" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me *e-mail*-in e datës 26.7.2024, protokolluar në ERE me nr. 814/14 prot., datë 26.7.2024, ku, gjithashtu, iu evidentua dhe dokumentacioni, i cili ende mbetet i paplotësuar nga ky aplikim. Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 814/15 prot., datë 29.7.2024, shoqëria ka depozituar informacion

plotësues të aplikimit.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; pikën 1.3 germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 2.1 germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "Age Erzen" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1655 rep., nr. 367/3 kol., datë 3.12.2020, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin hidrocentralit 'Hekal', me kapacitet 1940 kw, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë";

- Është pajisur me lejen për përdorimin e burimit ujor, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor Erzen, datë 18.9.2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit Ujor nr. 5, datë 16.9.2020, për prodhim hidroenergjie nga HEC "Hekali";

- Ka nënshkruar me shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. marrëveshjen nr. 1966/2 prot., datë 17.4.2020, për lidhjen e HEC "Hekal", me fuqi 1940 kw, me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më 9.6.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi dhe operimi i HEC "Hekal", me fuqi të instaluar 1940 kw" dhe ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je.

- Shoqëria disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujor për prodhim hidroenergjie nga HEC "Hekal", e cila është aktualisht e vlefshme, por duke qenë se afati i saj nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 18.9.2025.

- Vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që, në rast se nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, brenda këtij afati dhe ka një urdhër për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka dokumentuar në ERE letrën e interesit përkatëse për të realizuar projektin 100% me kredi bankare, sipas vlerës që rezulton nga kontrata me MIE-n, si dhe referuar mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit. Shoqëria, po ashtu ka informuar ERE-n se disbursimi i kredisë do të fillojë menjëherë pas licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Për sa i përket financimit të deritanishëm, shoqëria ka deklaruar se është dakordësuar me kontraktorin e përgjithshëm që likuidimet përkatëse do të kryhen pas disbursimit të kredisë dhe me certifikimin e punimeve. Në këto rrethana vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE, dakordësinë e kontraktorit të punimeve, të shprehur me një aktmarrëveshje, deklaratë apo çdo akt tjetër ndërmjet palëve për financimin e shpenzimeve për ndërtimin e veprës deri në disbursimin e kredisë dhe certifikimin e punimeve, si dhe për mënyrën e shlyerjes së këtij investimi.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, afat i cili do të fillojë nga data e parashikuar nga shoqëria për fillimin e operimit, pra nga data 1.3.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Age Erzen" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Hekali", me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë, për një afat 30-vjeçar, duke filluar nga data 1.6.2026.

2. Shoqëria "Age Erzen" sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 18.9.2025.

3. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe ka një

vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Brenda datës 30 tetor 2024, shoqëria duhet të depozitojë në ERE, dakordësinë e kontraktorit të punimeve për financimin e shpenzimeve për ndërtimin e veprës deri në disbursimin e kredisë dhe certifikimin e punimeve, si dhe për mënyrën e shlyerjes së këtij investimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "Age Erzen" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, "Furnizuesin e Tregut të Lirë" sh.a. dhe "Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 155, datë 31.7.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "FAETHON" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/8 prot., datë 29.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Faethon' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Faethon" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 31.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Faethon" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër.
- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.6.2024 dhe 5.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 3.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1481, datë 6.6.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 1125/3 prot., datë 4.6.2024, i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar apo plotësuar pjesërisht.
- Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1125/4 prot., datë 19.6.2024, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s, për të plotësuar brenda një kohe të arsyeshme pjesën e mbetur të dokumentacionit, i cili duhet të merret në Greqi, për shkak se 3 administratorët e saj janë shtetas

grekë dhe aktualisht rezidentë në Greqi.

- ERE, me shkresën nr. 1125/5 prot., datë 28.6.2023, i është drejtuar shoqërisë me kërkesën për informacion, në lidhje me afatin e arsyeshëm, brenda të cilit ajo do të plotësojë dokumentacionin e aplikimit të saj. Në vijim, me shkresat nr. 125/7 prot., datë 23.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se nga ana e shoqërisë duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **Germa "b":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues që ortaku kryesor i saj e disponon shumën që do të vendosë në dispozicion të ndërtimit të parkut fotovoltaik; dokumentacion vërtetues për pjesën e mbetur të vlerës së investimit; saktësimin e modalitetit të ri të financimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- **Germa "c":** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

- Po ashtu, shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion teknik mbështetës, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaik (si p.sh.: garancia e paneleve të përzgjedhura për parkun fotovoltaik).

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores, parashikohet, se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t'u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Faethon" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Faethon" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve, përshirë dhe çdo komunikim të nevojshëm me institucion /organet e tjera

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "Faethon" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 156, datë 31.7.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ACHELO" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "KOTORRI"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe

nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1534/9 prot., datë 30.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Achelo' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kotorri",

konstatoi se:

- Shoqëria "Achelo" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534 prot., datë 20.6.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Kotorri" me kapacitet prodhues 1.9 mw, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 2.7.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Achelo" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 3.7.2024 dhe 4.7.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 12.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën me nr. 1534/4 prot., datë 5.7.2024, i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe njoftimin për zhvillimin e një seance dëgjimore, në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1534/5 prot., datë 18.7.2024 dhe nr. 1534/7 prot., datë 23.7.2024, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se nga ana e shoqërisë duhet të plotësohet dhe sa vijon:

- Shoqëria disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujor për prodhim hidroenergjie", e cila është aktualisht e vlefshme, por duke qenë se afati i saj nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ashtu si në rastet analoge, duhet të depozitohet në ERE leja e rinovuar brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 18.9.2025.

- Për sa parashikohet në VNM-në paraprake, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentralit, në seancën dëgjimore të datës 15.7.2024, shoqëria ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet, ajo është pajisur me vendimin Këshillit Kombëtar të Territorit më datë 5.7.2024, por nuk është zbardhur leja e ndërtimit. Në të tilla rrethana, vlerësohet që të dokumentohet në ERE data e fillimit të punimeve, por jo më vonë se data 14.9.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).

- Në kuptim të nenit 9, pikës 1.3, germave "b" dhe "c", shoqëria ka depozituar në ERE analizën ekonomike dhe financiare, planin e biznesit ku është bërë një përshkrim i të dhënave të përgjithshme të projektit për ndërtimin e HEC "Kotorri" nga shoqëria "Achelo" sh.p.k., si dhe është paraqitur preventivi i detajuar në formë tabelare. Për sa i përket mënyrës së financimit, shoqëria ka ndryshuar formën e financimit, ku shoqëria do ta financojë 100% me fondet e ortakëve. Gjithashtu, shoqëria "Achelo" sh.p.k. do ta kthejë huan për një periudhë 10-vjeçare nga të ardhurat që do sigurojë nga shitja e energjisë. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues që ortakët e saj e disponojnë shumën që do të vendoset në dispozicion për ndërtimin e veprës; dokumentacion vërtetues mbi saktësimin e modalitetit të ri të financimit.

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores, parashikohet, se: "Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë".

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë për të sqaruar informacionin/dokumentacionin që ka mbetur ende për t'u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Achelo" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të

energjisë elektrike. Shoqëria duhet të depozitojë këtë informacion/dokumentacion në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë "Achelo" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kotorri", me kapacitet të instaluar 1.9 mw.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit brenda 20 (njëzet) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Achelo" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 157, datë 31.7.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "H.K. HEC GRABOVA 2" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 996/8 prot., datë 30.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi licencimin e shoqërisë 'H.K HEC Grabova 2' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996 prot., datë 25.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Grabova 2", me kapacitet prodhues 10.8 mw, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 9.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.5.2024 dhe 13.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.6.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.7.2024 ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 996/3 prot., datë 20.5.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresën me nr. 996/4 prot., datë 3.6.2024, ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Në vijim, për shkak të saktësimeve/sqarimeve, në lidhje me afatet e ndërtimit dhe të vënies në punë të hidrocentralit në referencë të përcaktimeve të kontratës së koncesionit nr. 2026 rep., nr. 926/1 kol., datë 14.9.2017, për ndërtimin e hidrocentralit "Grabova 2", të ndryshuar, Bordi ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 9.7.2024, vendosi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 (tridhjetë) ditë mbi aplikimin e shoqërisë "H.K HEC Grabova" sh.p.k., për t'u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Grabova 2".

- ERE, me shkresën me nr. 996/6 prot., datë 19.7.2024, njoftoi shoqërinë mbi vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, mbi zgjatjen e afatit dhe i kërkoi që të saktësojë/sqarojë në lidhje me afatet e

punimeve dhe fillimin e operimit të hidrocentralit.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996/7 prot., datë 23.7.2024, ka depozituar sqarimet/saktësimet e kërkuara, dhe me shkresën e fundit me nr. 996/7 prot., datë 23.7.2024, ka përcjellë në ERE dokumentacionin drejtuar MIE për zgjatjen e afatit të vënies në punë të hidrocentralit "Grabova 2".

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesë më të lartë se ajo që kërkohet për një njësi gjeneruese, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores, ndaj, në vijim, do të bëhen sistemimet përkatëse.

- Për sa i përket mbështetjes financiare për realizimin e projektit, shoqëria ka përcjellë kontratën e nënshkruar të kredisë me Raiffeisen Bank sh.a. me nr. 6412 rep., nr. 3953 kol., datë 22.10.2022, ku shprehet dakordësia për këtë projekt, me afat vlefshmërie deri në 30 korrik 2024. Në mbledhjen e Bordit të datës 31.7.2024 përfaqësuesi i shoqërisë "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k. sqaroi se kanë bërë rishikim/shtyrje të këtij afati në kushtet e kontratës aktuale dhe se brenda muajit gusht 2024 do të disponojnë kontratën e re. Për këtë arsye, vlerësojmë t'i lihet kusht shoqërisë të përcjellë brenda muajit tetor 2024, kontratën e rishikuar të nënshkruar me bankën.

- Kontrata e koncesionit e formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentralit "Grabove 2" me nr. 2026 rep., nr. 926/1 kol., datë 14.9.2017, nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe subjektit "H.K HEC Grabova 2" sh.p.k., në nenin 4 të saj përcakton, se kjo kontratë lidhet për një afat prej 35 (tridhjetë e pesë) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të saj dhe mbaron në vitin e 35-të.

- Kontratat shtesë nuk kanë rivënë në afat kontratën bazë, në lidhje me vlefshmërinë e saj, si e tillë ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 6 vjet e 11 muaj nga periudha koncensionare dhe periudha e mbetur është 28 vjet e 1 muaj. Vlefshmëria e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë do të nisë nga data 24.10.2024, datë në të cilën shoqëria do të fillojë operimin sipas afateve të kontratës me MIE-n dhe do të jetë e vlefshme deri në përfundim të afatit të kontratës, pra deri më 14.9.2052.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "H.K. HEC Grabova 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Grabova 2", me kapacitet total të instaluar 10.8 mw, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, qarku Elbasan, duke filluar ky afat nga data 24.10.2024 deri në 14.9.2052.

2. Shoqëria "H.K. HEC Grabova 2" sh.p.k. të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga ana e saj, mbi zgjatjen e afatit të datës së fillimit të operimit të hidrocentralit "Grabova 2".

3. Shoqëria "H.K. HEC Grabova 2" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e kredisë të nënshkruar me Raiffeisen Bank sh.a. të rishikuar, brenda muajit tetor 2024.

4. Ky vendim është objekti rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 158, datë 31.7.2024

MBI DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PARKU FOTOVOLTAIK "BLUE 1" I SHOQËRISË "SPV BLUE 1" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; nenit 7 të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, të ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1553/6 prot., datë 29.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SPV Blue 1' sh.p.k. për dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik 'Blue 1'",

konstatoi se:

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1553/2 prot., datë 28.6.2024 dhe nr. 1533/3 prot., datë 3.7.2024, shoqëria "SPV Blue 1" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin qershor 2024 nga parku fotovoltaik "Blue 1".

- Referuar përcaktimeve të "Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, garancia e origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet me bazë mujore ose vjetore, sipas kërkesës se aplikuesit.

- Mbështetur në përcaktimet e nenit 22, pika 6, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me shkresën nr. 1553/4 prot., datë 22.7.2024, ERE i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për muajin qershor 2024 dhe numrin serial të aparatit matës.

- Në përgjigje, me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1553/5 prot., datë 29.7.2024, OST sh.a. ka informuar se nga centrali fotovoltaik "Blue 1", gjatë muajit qershor 2024 (1–30) është prodhuar 10,657 mwh.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga "Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar.

- Për sa më sipër vlerësohet dhënia e garancisë së origjinës për energjinë e prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", i shoqërisë "SPV Blue 1" sh.p.k., për periudhën 1–30 qershor 2024, sipas sasive të dhëna nga OST sh.a., pra për 10,657 mwh.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", garancia e origjinës është e vlefshme për një vit, duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaik "Blue 1", i shoqërisë "SPV Blue 1" sh.p.k., gjatë periudhës 1–30 qershor 2024, për sasinë 10,657 mwh.

2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 1" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 159, datë 31.7.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 15, DATË 31.1.2019, "MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, TË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, E REGJISTRUAR PRANË QKB-së, SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SHA), TRANS ADRIATIC PIPELINE AG, I NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 4, pika 50, 35, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 3, pika 1, germa "a", 53, pika 2, dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1683/1 prot., datë 30.7.2024, të drejtorive teknike të ERE-s, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, 'Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e riregjistruar pranë QKB-së, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG, i ndryshuar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 15, datë 31.01.2019, "Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e riregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a), Trans Adriatic Pipeline AG, i ndryshuar", me vendimin nr. 152, datë 13.6.2022, ndër të tjera ka vendosur: "2. Jo më vonë se data 1.7.2024, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021, 'Për bashkëqeverisjen'".

- Në kuadër të plotësimit të këtij kushti, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1683 prot., datë 26.7.2024, shoqëria ka informuar se ka përfunduar procesin e regjistrimit të të drejtave të tokave të blera dhe servitutit, si për korridorin e tubacionit të gazsjellësit, ashtu edhe për objektet mbitokësore (stacioni i kompresorëve, stacioni matës dhe stacionet e valvulave bllokuese).

- Po ashtu shoqëria bën me dije, se në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", dhe kuadrit ligjor për shpronësimin, këto të drejta janë regjistruar në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfshirë dhe të drejtat mbi tokën shtetërore të siguruara nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave.

- Shoqëria argumenton, se sipas dispozitave të Marrëveshjes, pronësia dhe të drejtat e servitutit, të siguruara nga procesi i shpronësimit, duhet të transferohen në emër të TAP-it, në përputhje me shtojcën 1, pjesa 1, paragrafët "h" dhe "i" të kësaj marrëveshjeje. Ky proces është i mundur vetëm nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave dhe për këtë shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën zyrtare të datës 7.6.2024 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës lidhur me këtë proces, ku ka kërkuar bashkëpunimin e këtyre institucioneve, si institucione përgjegjëse, por dhe të specializuara në këtë fushë, në sigurimin e pronave dhe konsolidimin e të drejtave pronësore të ndikuara nga gazsjellësi TAP. Për sa më sipër, shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të përgjigjes lidhur me këtë proces.

- Po ashtu, shoqëria ka sqaruar, se ndryshimet që kanë ndodhur në procedurat që lidhen me kadastrën, të cilat tashmë kryhen vetëm nëpërmjet portalit *e-Albania,* kanë shkaktuar vonesa edhe në procesin e përfundimit të regjistrimit të godinave dhe ka theksuar se të gjitha këto procese po i ndjek me institucionet përkatëse në mënyrë të vazhdueshme.

- Për gjithë sa më sipër, shoqëria ka kërkuar nga ERE që të shtyjë afatin e përmbushjes së kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15/2019, të ndryshuar, duke sqaruar se koha e nevojshme për të përgatitur dhe për të miratuar vendimet e qeverisë është një proces jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të TAP-it, e për këtë arsye ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të miratuar një shtyrje të dytë për një periudhe 24-mujore, si në vendimin e mëparshëm.

- Për gjithë sa më sipër argumentuar e kërkuar nga shoqëria, duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit të gazsjellësit TAP, shtrirjen e madhe të tij dhe kompleksitetin në pajisjen me të gjithë dokumentacionin e kërkuar pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15/2019, të ndryshuar, e po ashtu, duke marrë në konsideratë përpjekjet e shoqërisë për t'u pajisur me këtë dokumentacion, sikurse dhe kërkesa drejtuar institucioneve përgjegjëse për bashkëpunim në këtë proces, dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 53, pika 2 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vlerësojmë të arsyetuar kërkesën e shoqërisë për të shtyrë me 24 muaj afatin e plotësimit të këtij kushti, pra deri më 1.7.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, të ndryshuar, si vijon:

"2. Jo më vonë se data 1.7.2026, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021, 'Për bashkëqeverisjen'".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Trans Adriatic Pipeline AG Albania", degë e shoqërisë së huaj dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/09/09 13:32:07 +02'00'
3679f4bab9df461c936dc8f20176d2272024090913
315672031

Çmimi 320 lekë

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)